



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 41

Prishtinë, më 21.05.2012 në ora 15:45

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Glauk Konjufca, Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, Petar Miletic, Rasim Demiri dhe Xhevdet Neziraj.

Mungon: Lirije Kajtazi, Mufera Sinik

Emrat e përfaqësuesve nga Zyra e OSB-së. Komisari i lartë për pakicat kombëtare të Norvegjië z. Knut Vollebaek dhe Alexandar Hug.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësues të OSB-ja Elita Vokshi, Lejla Selimi, përfaqësuesi nga KDI-Sakibe Jashari, dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Kordinatore - Natasa Prica-Tisma, zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Takim i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim me Komesarin e lartë për pakicat kombëtare të Norvegjië z. Knut Vollebaek

Tema:

„Garancionet për mbrojtjen e pakicave pas mbikëqyrjes së pavarësisë, politikës për gjuhët dhe politikës arsimuese, sfidat për stabilitet dhe siguri”

Goran Marinkovic – shprehu qëndrimin e tij se është falënderues për takimin e përbashkët me përfaqësuesit e zyrës **Norvegjeze** .

Kryesuesi- Në fjalën e tij tha se Komisioni është në përbërje të plotë nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve të cilët jetojnë në Republikën e Kosovës. Veçoi se Komisioni vepron në fushën e kompetencave të saja, në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore në barazi të plotë dhe efikase në të gjitha sferat e jetës. Ai foli për rëndësinë e temës dhe për diskutim fjalë ia dha komesarit.

Knut Vollebaek - komesari- falenderoi komisionin për gadishmërinë në takim të përbashkët me antarët e komisionit dhe paraqiti interesim të kuptojë se cilat janë fokuset e tyre. Në bazë të informative tha se ky komision ka një rëndësi të vacant sepse shqyrtohen të gjitha projektligjet të cilat janë në interes të komuniteteve dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislationit edhe pse dihet është proces i vështirë zbatueshmëria në praktik.

E informoi komisionin lidhur me punën e tij si komesar i lartë për pakica kombëtare në kuadër të OSB-së. Misioni i tij përfshin tri fusha siq është: puna e përfaqësuesve të komuniteteve lidhur me të drejtat e tyre pas mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës; zbatimin e ligjit për gjuhët në institucionet përkatëse dhe integrimi i pakicave.

Sa i përket OSB-së gjithnjë ka ekzistuar një partneritet i ngushtë me ECMI - Qendra Europiane për Çështjen e Pakicave, e cila prej disa vitesh funksionon në Kosovë.

Gjatë vizitës së tij ai do të takohet edhe me komunitetin goran, ngase ata kanë probleme në fushën e arsimit ku do t'ju ndihmohet në vështirësitë që ata hasin në këtë drejtim. Ai gjithashtu theksoi se do të prezantohet një tekst shkollor para Ministrisë së Arsimit që ka të bëjë me arsimin ndërkulturor për klasë të VI.

Ai diskutoi edhe lidhur me çështjen e bisedimeve Prishtinë-Beograd, ngase këto bisedime në masë të madhe prekin edhe komunitetet. Pyetja e tij është si parashihet mbarvajtja e bisedimeve, roli i tyre në realizimin e të drejtave dhe si mund të ndihmojë Bashkësia Europiane në këtë aspekt. Si çështje tjetër me rëndësi është rrjedha e situatës në veri të Mitrovicës, si qëndron situata atje pasi është gjendje e lëkundshme dhe a do të preken pakicat në jug nga zhvillimet në veri.

Kryesuesi - në fjalën e tij tha se Komisioni për të Drejtat e Komuniteteve dhe Kthim është një ndër komisionet thelbësore në Parlamnet. Mënyrën e përfaqësimit të komunitetit goran në komision Shqetësimet tona janë se çfarë do të ndodhë me çështjet e komuniteteve joshumicë në aspekt të legjislationit për të drejtat e minoriteteve dhe përpjekjet për zbatimin e tij në Kosovë pas mbikëqyrjes së pavarësisë. Dhe parashitohen shumë pyetje lidhur me decentralizimin, përfaqësimin e komuniteteve në sektorë të ndryshëm si në politik, ekonomi dhe në shumë sfera tjera.

Ai shprehu paknaqsinë që ka lidhur me mos zbatimin e gjuhës serbe si gjuhë e dytë zyrtare në të gjitha sektorët e shoqërisë Kosovare, por shpreson se me një angazhim më të madh dhe në bashkëpunim me Qeverinë, ligji për gjuhët do të zbatohet si dhe ligjet tjera.

Lidhur me bisedimet Prishtinë-Beograd ai mendon se zgjidhja më e mirë do të jetë dialogu dhe se marrëveshjet e arritura duhet të zbatohen dhe të arrihen ndryshime konkrete. Sa i përket pjesës së veriut të Mitrovicës mendon që duhet të ketë vullnet të mirë që qytetarët të integrohen në shoqërinë Kosovare.

Petar Miletic - falnderoi komesariat e lartë për pakicat kombëtare të OSBE-së për angazhimet dhe kontributin e tyre të deri tanishëm.

Ai shprehu shqetsimin lidhur me ndryshimet që po bëhen në kushtetutë ngase nuk do të ketë karrike të siguruar në Parlamentin e Kosovës.

Kur bëhet fjalë për çështjen e dialogut tha se me entuziazëm ka prit që të krijohen marrdhënie më të mira mes Prishtinës dhe Beogradit, ku do të ketë integritet të komunitetit serbë në shoqërinë Kosovare, por kjo marrëveshje nuk është realizuar. Ai shtoi se qytetarët ende nuk kanë njohuri për bisedimet e marrëveshjeve të arritura.

Kur bëhet fjalë për gjuhën, ai mendon se kjo çështje është rregulluar me ligj por vetëm duhet vullneti i mirë për implementimin e tij në praktikë.

E informoi komesarin se më herët ka qenë pjesëmarrës në një mision andaj kërka e tij ishte që të ketë misionet të ngjashme.

Komesariati - ai bëri pyetje lidhur me çështjen e fundit që ka të bëjë me raportin e KIPRED-it dhe dëshira në një mënyrë t'i sfidon antarët e komisionit ta lexojnë këtë raport dhe pasi të kthehet në vjeshtë të diskutohet bashkarisht lidhur me opinionet e tyre.

Xhevdet Neziraj- Me theks të vacant tha se do të fokusohet në problemet e komunitetit të cilin ai përfaqson, duke shprehur mendimin e tij se komuniteti egjiptian është i interesuar të integrohet në shoqërinë Kosovare si komunitetet tjera. Komuniteti egjiptian ka probleme të ndryshme si në aspektin ekonomik, social, arsimor dhe në aspekte tjera shoqërore. Ekzistonë një varg mekanizma të cilët mirren me të drejtat e komuniteteve duke filluar nga komisioni për të drejtat e komuniteteve, Këshilli Konsultativ për Komunitete, të cilat mekanizma pothuajse udhëheqen nga komuniteti serbë.

Kryesisht edhe në pakon e Ahtisarit përmenden më shumë komuniteti serb se sa komunitetet tjera. Pra ngecjet rrjedhin nga faktori ndërkombëtar dhe ai vendor nga se në veçanti janë fokusuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serbë andaj po stagnohet çështja e integritetit të komuniteteve tjera.

Sa i përket procesit të riadhesimit, tha se është çështje e ndjeshme prandaj bëri kërkesë Komisarit që të mos rikthehen pjestret e komunitetit RAE pasi dihet se ekzistojnë probleme të shumta socialo-ekonomike.

Njëherit shprehu paknaqsin e tij lidhur me mënyrën e punësimit të komunitetit egjiptian në ndërmarrjet publike.

Glauk Konjufca - diskutoi lidhur me çështjen e trajtimit të pakicave në Kosovë dhe mënyrën e konceptimit të pakos së Ahtisarit e cila plotësisht kundërshtohet nga grupi i tij parlamentar. Sipas tij faktori ndërkombëtar problemin në mes Kosovës dhe Serbisë e ka qasur si konflikt etnik e në realitet nuk është nga se ka qenë konflikt dhe luftë e armaturë mes okupatorit dhe një populli që ka luftuar për çlirimin e vendit të tij.

Nëse kjo situatë do të ishte si një pikënisje për shqyrtim atëherë do kishim rezultate më të mira për komunitetet por në thelb pakaja e Ahtisarit iu është çasur problemit si etnitet andaj egziston ndarja mes komunitetit serb dhe të komuniteteve tjera, e cila e dëshmon se në thelb pikënisja ka qenë ndarja.

Gjatë integrimit të popullit serb ai tha se ka hasur dy ligjësi të caktuara: e para është se ku ka struktura paralele të Serbisë nuk ka integritet të sërbeve dhe e dyta ka vërejtur se ku ka mirëqenie më të mirë ka integritet më të madh të sërbeve.

Sa i përket pyetjes së integrimit pajtohet me z. Xhevdet, nga se një pjesë e komuniteteve e kanë pranuar procesin e integrimit deri sa një pjesë e komunitetit serbë nuk është pajtuar. Ai shtoi se problemi është më i thjeshtë nga se Serbia me strukturat e veta të organizuara brenda Kosovës dhe investimi i ndërkombëtarve për integrimin e sërbeve ka dështuar, gjë të cilën e dëshmon edhe me shembuj, Nëse një komunitet i caktuar e konisedron veten lojal atëherë gjithmonë do të ketë probleme ndaj shtetit të Kosovës.

Në fjalën e tij tha se pajtimi mund të arrihet por i mungon thelbi sepse nuk mund të ketë pajtim me mbajtjen e seminareve por duhet të respektohet dhe njëherit të zbatohet drejtësia.

Kur bëhet fjalë për zgjidhjen e bisedimeve me Serbinë ai tha se është çështje e përealizuar ngase tani më në krye të shtetit Serb është zgjedhur një person i cili ka qenë pjesë e qeverisjes së viteve 1998-1999, qeveri e cila si piksynim kishte spastrimin etnik.

Kryesuesi – Ai pajtohet se secili ka të drejtë të shpreh mendimin e vet lidhur me çështjet e cekura por nuk mund të thuhet se pajtimi dhe integrimi mund të vie në këtë moment Por shpreson se bashkarisht do të ndikojmë që të rregullohet çështja e të drejtave të komuniteteve joshumicë në aspektin e legjislacionit dhe të njejtat të zbatohen në tërë territorin e Kosovës.

Glauk Konjufca - ai sqaroi se u keqkuptua ngase nuk është kundër pakicës serbe, ai përmendi edhe gjëra nga historia të cilat flasin se populli shqiptarë me atë sërbe kanë pasur mardhënie shumë të mira dhe thekosi që këto mardhënie prap do të vireshin në binarë në qofse Beogradi qëndron sa më larg Kosoves.

Komesariati - ai dha disa komente lidhur me parafolsit, i dha të drejtë z. Xhevdet Neziraj lidhur me neglizhencën që u bëhet komuniteteve më të vogla dhe se kjo çështje është e padrejtë. Për këto komunitete është vështirë të ngrisin zërin nga se fatkeqisht kjo ndodh edhe në vende tjera jo vetëm në Kosovë. Ceku se do të mundohen të japin kontributin e tyre që komunitetet jo shumicë të mos neglizhohen, ku përmendi edhe botimin e tekstit shkollor, ku janë munduar të shpalosin kulturën e gjithë komuniteteve.

Ai shpjegoi terminin "integrim" dhe sipas tij ky term është keqkuptuar nga ata sepse të gjitha komunitetet duhet të integrohen në shoqëri në aspektin e kulturorës, gjuhës, arsimit e cila duhet të pranohet në shoqëri si tërësi.

Ai u pajtua me z. Konjufca që problemet nuk zgjidhen me seminare por nga aktivitetet e grupit punues në të cilin pjesëmarrës ishte z. Petar Miletic dhe se në bazë të raportit të KIPRED-it, i cili ka për qëllim të mbrojë drejtësinë edhe pajtimin por kjo nuk mund të detyrohet por kjo duhet të vijë nga vet shoqëria.

Kryesuesi - e falnderoi z. Knut Volebeg për të gjitha informatat të cilat ishin produktive për komision dhe se vizitat e kësaj natyre janë të mirëseardhura në çdo kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 17:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic